



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË  
DHËNAVE PERSONALE

Nr. 915 Prot.  
13

Tiranë, më 13 /10/2016

VENDIM

Nr. 68, datë 13 / 10 / 2016

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjës "a" të nenit 31/1 të ligjit nr.9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale,

V Ë R E N:

Ankuesi/ Qendra "Res Publica" përfaqësuar nga Z. \_\_\_\_\_, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit ankesën nr. 915 Prot., datë 01.09.2016, ndaj Inspektoratit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumentave zyrtare".

Ankuesi në cilësinë e kërkuetit, me kërkesën nr. 027/16 Prot., të datës 15.07.2016 ka kërkuar nga Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit t'i vihet në dispozicion:

1. Kopje të Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar Tiranë, me objekt: "Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e ndjekura për arkëtimin e detyrimeve, etj." lloji i auditimit: "Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe ekonomiko - financiar", për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.06.2013.
2. Kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar Tiranë ka raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërpërmendur.

Pretendimi i ankuesit provohet edhe nga rceta postare nr. 50, datë 15.07.2016 ora 5:58. Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, nuk i ka kthyer përgjigje kërkuetit duke refuzuar në këtë mënyrë dhënien e informacionit. Për rrjedhojë ankuesi pretendon se është cënuar në të drejtën për informim dhe për këtë arsye ka depozituar ankim pranë Zyrës së Komisionerit.

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri me urdhrin Nr.187, datë 07.09.2016 urdhëroi kryerjen e inspektimit administrativ pranë Autoritetit Publik/Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit.

Pranë Autoritetit Publik u konstatua se nuk është caktuar ende koordinatori për të drejtën e informimit si dhe mungesa e bashkëpunimit për kryerjen e procedurave të mëtejshme.

Zyra e Komisionerit, vlerëson se informacioni mbi kopjet e Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer nga Kontrolli Lartë i Shtetit, me objekt "Kopje të Raportit Përfundimtar të

*Auditimit të kryer në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar Tiranë, me objekt: "Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e ndjekura për arkëtimin e detyrimeve, etj." lloji i auditimit: "Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe ekonomiko - financiar" për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.06.2013. dhe kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar Tiranë ka raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit të sipërpërmendur", është informacion publik në kuptim të nenit 2, pika 2 e Ligjit 119/2014 dhe dhënia e tij nuk mund të refuzohet.*

Çdo autoritet publik, në kuptim të nenit 7, pika "dh" e Ligjit 119/2014, duhet të ketë publik në programin e transparencës, mekanizmat monitorues dhe të kontrollit që veprojnë mbi autoritetin publik, përfshirë planet strategjike të punës, raportet e auditimit nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose subjekte të tjera, si dhe dokumentet që përmbajnë tregues të performancës së autoritetit. Në këto kushte, ky lloj informacioni duhet të ishte bërë publik në Programin e Transparencës së autoritetit publik/ Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit. Për sa më lart, duke qenë se informacioni i kërkuar nga Qendra "Res Publica" përbën informacion publik bazuar në nenin 2, pika 2 dhe nenin 7, shkronja "dh" e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit" si dhe në respektim të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale" i ndryshuar, duhet bërë publik në Programin e Transparencës së këtij institucioni.

Theksojmë, se e drejta për t'u informuar është një prej të drejtave themelore të njeriut, e parashikuar në nenin 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Kjo e drejtë duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funkcionimi i tyre do të ishte në interesin e të dy palëve.

Në këto kushte, në lidhje me ankesën e Qendrës "Res Publica" ndaj Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, Komisioneri vlerëson se ankesa është e bazuar në ligj dhe si e tillë ajo duhet pranuar.

## **PËR KËTO ARSYE**

Bazuar në shkronjat "b" dhe "ç" të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr.119/2014 "Për të drejtën e informimit", shkronjën "a" të pikës 1, të nenit 18 të ligjit nr 49/2012 "Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative",

## **V E N D O S A:**

1. Pranimin e ankesës së Qendrës "Res Publica", Nr. 915 Prot., datë 01.09.2016, ndaj Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, me objekt "Ankim ndaj refuzimit për dhënie të informacionit dhe kopje të dokumenteve zyrtare".
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik/ Inspektorati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit, për vënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar (Kopje të Raportit Përfundimtar të Auditimit të kryer në Inspektoratin Ndërtimor Urbanistik Kombëtar Tiranë, me objekt: "Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e ndjekura për arkëtimin e detyrimeve, etj." lloji i auditimit: "Për auditimin e ligjshmërisë, rregullshmërisë dhe ekonomiko - financiar" për periudhën e veprimtarisë 01.01.2011 deri 30.06.2013 dhe kopje të të gjitha informacioneve të mëvonshme që Inspektorati Ndërtimor Urbanistik

Kombëtar Tiranë ka raportuar në KLSH për përmbushjen e detyrave që i janë lënë sipas Raportit Përfundimtar të Auditimit), brenda datës 18.10.2016.

3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.
4. Ky vendim u dha sot në datë 13.10.2016.

